



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

MENDIM NË PAKICE

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës për pikën 1 në lidhje me Vendimin nr. 156, datë 15.05.2020, të miratimit të listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë shkollës së magistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, për Këshilltarë Ligjorë.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **datë 15.05.2020** në pikën e tretë të rendit të ditës, është përfshirë për shqyrtim në këtë mbledhje projektvendimi “Për miratimin e listës emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magistraturës, për vitin akademik 2020-2021, për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë” i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.”

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kam mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”...

Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t’i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit...., parashtrijmë sa më poshtë argumentet tona, në lidhje me këtë çështje:

- Për sa i përket aspektit formal procedural më duhet të theksoj se;

Bazuar në nenet 34 pika 6 e ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilltari ligjor jo magistrat duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare; ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit European; d) aftësi të shkrimit dhe arsytimit ligjor; dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme; e) të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.

Gjithashtu bazuar në nenet, 53, 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 274 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, në respektim të procedurës së përcaktuar në ligj, ka kryer verifikimin e plotësimit të kritereve, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga çdo kandidat.

Nga lista e kandidatëve që konkurrojnë për Këshilltarë të paraqitur nga Komisioni vihet re mungesë të plotësimit të kritereve specifikisht të pikave *b, c, e, d*, të nenit 34 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” si më poshtë:

b) përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;

c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;

d) aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;

e) të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.

Qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për kandidatet e kualifikuar për të kaluar në fazën e testimit për pozicionin Këshilltarë dhe pse me mungesë të dokumente që provojnë autorësinë e artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, aftësitë të shkrimit dhe arsyetimit ligjor etj., bien ndesh me pikën 6 te nenit 34 mbi kriteret që duhet të plotësoj “Këshilltari ligjor jo magjistrat “.

Për sa më sipër, shprehim qëndrimin dhe argumentet tona dhe votuam **“KUNDËR”**

**Anëtari
Alban Toro**